

Bashkim Aliji, PhD¹

UDC: 28-47-523(494:=18):[616.98:578.834]-036.21
37.014.523:28-523(494:=18):[616.98:578.834]-036.21

LIGJËRIMI FETAR NË KOHË PANDEMIË
- ligjërimi fetar në xhami të themeluara nga shqiptarët në
Zvicër, si shembull -

ВЕРСКО ПРЕДАВАЊЕ ВО ПАНДЕМИСКИ ВРЕМЕ
- верски предавања во џамии основани од Албанци во
Швајцарија, како пример -

RELIGIOUS LECTURE IN PANDEMIC TIMES
- religious lecturing in mosques founded by Albanians in
Switzerland, as an example -

Abstract

This paper addresses the issue of religious lecture at the time of the Covid-19 Pandemic, as a very sensitive and challenging phase for religious leaders and for all of humanity on many levels. In this paper it is concluded that religious leaders are relevant factors in the societies where they operate, in particular their key function in connecting the community with society, orienting the community in the right lines of forming an opinion on various phenomena and events, correcting erroneous views and doctrines, and in all this, the religious lecture of the imams, takes precedence.

This paper explains that the emphasis of the imams in communicating with the congregation was placed in the way of dealing with the Covid-19 pandemic, in the way of dealing with its social,

¹ Doktor në fushën e studimeve evropiane për integrim.

psychological, economic consequences, respecting the measures provided by the competent authorities.

In this paper it is concluded that the lecture of imams in pandemic times, is characterized by these most important features: educational, motivation, theological pragmatism which was distinguished by two important standards: anti-fatalism and strong faith, social character which is focused on the importance of family relationships in Islam, the moral punishment of severing family ties, and the need for closer communication with the family.

Keywords: Religious discourse, imam, pandemic, congregation, communication.

Hyrje

Pandemia Covid-19, si dukuri mjaft komplekse e cila pati shtrirje gati në tërë botën, diktoi tempo të veçantë të zhvillimit të ngjarjeve dhe pati ndikim në më shumë fusha të veprimtarisë njerëzore, në rend të parë në fushën e medicinës dhe shëndetit publik, duke vazhduar pastaj fuqishëm edhe me fushën e biznesit dhe ekonomisë me të gjitha degët e saj, jetën shoqërore, politike, etj. Në këtë kontekst, nuk ngeli anash as jeta fetare, ngase shtrirja e kësaj pandemie e preku edhe organizimin e jetës fetare, institucionet fetare, faltoret dhe adhurimet kolektive të pjesëtarëve të feve. Pandemia Covid-19 imponoi për njerëzit masa të caktuara, të cilat u zbatuan në të gjitha institucionet, përfshi edhe ato fetare. Për atë, sikur edhe institucionet tjera, ashtu edhe institucionet fetare, u mobilizuan dhe ndërmoren hapa konkret që të përshtaten me ndryshimet që imponoi përhapja e Pandemisë Covid-19, në ballë të të cilave qëndroi xhamia dhe stabilizimi udhëheqës i xhamisë, i kryesuar nga imami.

Marrë parasysh se instrumenti kryesor dhe dominues i udhëheqësit fetar të xhamisë-imamit, është fjala, gjegjësisht ligjërata, gjë që paraqet vazhdimësi që nga koha e të Dërguarit të Zotit, Muhamedit, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, e deri në ditët e sotme, dhe kështu do të vazhdojë², edhe përkaj zhvillimit të teknikave të shumta të komunikimit me njerëzit, ligjërimi fetar i imamëve pati pozitë kyçe në menaxhimin e kësaj krize, sigurimin e stabilitetit shpirtëror dhe psikik të masës religjioze dhe më gjerë, ruajtjen e kohezionit shoqëror

² Shih: Aliu, Bashkim, Roli i xhamisë në mbrojtjen e identitetit fetar dhe kombëtar në Perëndim, Furkan ISM, Shkup, 2016, f.9.

dhe mbrojtjen e bashkësisë nga pasoja negative të natyrave të ndryshme. Për këtë, ishte shumë e rëndësishme çfarë stili do të zgjedh thirrësi që të arrijë të prekë në botën e brendshme të njeriut.³ Trajtimi i temave që lidheshin me gjendjen e Pandemisë Covid-19, dhe përçimi i mesazhit fetar nën hijen e pandemisë në fjalë, kërkonte përzgjedhje precize, qasje multidimensionale, formësim të ideve dhe pikëpamjeve mbi baza të mësimëve fetare autentike dhe komunikim aktiv.

Tiparet e ligjërimit fetar në kohë pandemie

Imamët në ligjëratat e tyre kanë qenë shumë të kujdesshëm dhe çështjen e pandemisë Covid-19, e kanë trajtuar me seriozitetin më të madh, pa u ndalur vetëm në dimensionin fetar të kuptimit të sprovave, sëmundjeve dhe epidemive, e për rrjedhojë edhe të pasojave të tyre në kryerjen e ritualeve fetare, në veçanti atyre kolektive, por edhe në dimensionin social dhe psikologjik të kësaj dukurie. Theksi i imamëve në ligjëratat e tyre *on line* dhe komunikimin me xhematin, u vu në mënyrën e ballafaqimit me këtë pandemi e cila e kaploi gjithë botën, në mënyrën e ballafaqimit me pasojat e saj sociale, psikologjike, ekonomike, respektimin e masave të parapara nga autoritetet kompetente, etj., e jo në debatet doktrinare që ka gjeneruar përhapja e kësaj pandemie, fryrjen e dyshimeve për ekzistimin apo mosekzistimin e këtij virusi, apo thënë ndryshe, teoritë e konspiracionit. Imamët në komunikimin e tyre me masën janë përqendruar në shndërrimin e kësaj gjendjeje në moment për reflektim, vetë-llogaritje, korrigjim dhe vetëdijesim, nisur nga fakti se masat dhe kufizimet të cilat u vunë nga ana e autoriteteve, ishin risi dhe befasi e pakëndshme për popullatën, në veçanti për atë shtresë e cila nuk kishte kaluar fazën e sistemit monist, por e njihte vetëm erën e demokracisë.

Ligjërimi i imamëve në kohë pandemie, mund të thuhet se është karakterizuar nga këto tipare më të rëndësishme:

EDUKATIV: Ligjërimi i imamëve, pa dyshim se është dashur të jetë edhe i natyrës juridike dhe legjislative islame, në kuptim të përcjelljes te masa të dispozitave fetare enkas për situata të veçanta, të cilat nuk kanë qenë rast në përpara, dhe më së paku, pjesa më e madhe e masës-xhematit, nuk është përballuar me këto situata që të kërkoj

³ Jeken, Fet'hi, *Si të thërrasim në Islam*, Furkan ISM, Shkup, 2000, f.19.

shpjegime fetare. Dhe këtë imamët e kanë bërë. Mirëpo, tipari më i dalluar i ligjërimit fetar në kohë pandemie, ka qenë edukativ, orientues dhe udhëzues, ngase kjo ka qenë dhe është dashur të jetë fokusi i masës së gjerë. Masa ka pasur nevojë për udhëzime, orientime dhe instruksione të përgjithshme se si duhet ta sheh gjithë këtë që po ndodh, para se të del në detaje të caktuara të natyrës juridike. Në fakt, ky është edhe karakteri i shpalljeve hyjnore, me theks të veçantë shpalljes së fundit hyjnore-Kur'anit, të cilat pjesën më të madhe ia kushtojnë aspektit shpirtëror, moral e social, ndërkaq më pak atij juridik. Kështu shprehet edhe mendimtari i shquar Muhamed Muteveli-esh-Sha'ravi, i cili duke e interpretuar ajetin: ***“Ne i shkruam në Pllaka udhëzime dhe shpjegime për gjithçka: “Merri këto me bindje dhe urdhëroje popullin tënd që t’i përvetësojë në mënyrën më të mirë. Unë do t’ju tregoj shtëpinë e të pabindurve”***⁴, nënvizon se *“Allahu i Madhërishëm sqaroi se në pllaka ka shkruar udhëzimet dhe detajet tjera të mësimave fetare për rregullimin e jetës. Udhëzimi aludon në atë që mos të japish ndonjë gjykim të ri, por këshillon dhe jep instruksione në bazë të gjykimeve të njohura që më parë. Këshilluesi dhe udhëzuesi nuk sjell dispozita dhe çështje të reja, por këshillon me ato gjëra fetare që pala i ka të njohura”*.⁵ Me fjalë tjera, ligjërimi fetar e ka rikthyer masën në mesazhet edukative të fjalëve të Zotit dhe të të Dërguarit të fundit të Zotit, Muhamedit, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, në disa pika:

▪ Duke shpalosur shembuj të durimit, përballimit të sprovave dhe zhvillimit krejt të natyrshëm të jetës dhe shoqërisë me sprova dhe momente të vështira. Historia në këtë rast ka shërbyer shumë pozitivisht, duke krijuar besim te masa se ne, si brez i kësaj kohe dhe etape historike, nuk jemi të vetmit që jemi përballuar me diçka të tillë, por edhe më herët, brezat tjerë gjatë historisë, janë përballur me sfida dhe momente të rënda që kanë rrezikuar edhe ekzistimin e tyre si bashkësi. Në fakt, ky ka qenë edhe roli i të dërguarve të Zotit në përgjithësi, e në veçanti kjo theksohet nga i Dërguari i fundit i Zotit, Muhamedi, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të dhe mbi gjithë të dërguarit e Zotit. Ai në një thënie të tij shprehet kështu: *“Zoti më ka dërguar mësues dhe lehtësues”*.⁶ Roli i mësuesit është edukativ dhe arsimor.

⁴ El-A'raf: 14.

⁵ Esh-Sha'ravi, Muhamed Muteveli, *Meusuatu-l-ehadith el-kudsijje ve sherhuha*, el-Mektebetu et-teufikijje, Kajro, pa vit botimi, vëll.II, f.69.

⁶ Hadithin e ka transmetuar Muslimi në Sahih-un e tij, kitabu: et-Talak, babu: bejani enne tehjire imreetihi la jekunu talakan, il-la bin-nijjeti. Shih: en-Nevevij, op. cit., vëll.X, f.70, nr.1478. nr.2795.

▪ Evitimi dhe shmangia e debateve ë thella doktrinare, dhe në veçanti atyre apologjetike për çështjet e fatalizimit, determinizmit dhe dënimit, në veçanti, dhe fokusimin në çështjet të cilat janë të karakterit të përgjithshëm edukativ për durimin në kohë sprovash, largimin nga mendimet e këqija të cilat e dëmtojnë shëndetin mental të njerëzve dhe pozitën e tij fetare, raportin e tij me Zotin dhe botëkuptimin e tij për fenë dhe Zotin. Me pak fjalë, lëshimi në debate të këtilla me masën e gjerë në përgjithësi, e në veçanti në kontekst të epidemive, siç është rasti konkret me pandeminë Covid-19, do të shkaktonte polarizime, konfuzion dhe ngatërrim të çështjeve, e nuk do të kontribuonte në qartësimin dhe lehtësimin e gjërave, si dhe nuk do të stimulonte optimizëm, stabilitet dhe kohezion në shoqëri.

▪ Theksimi i instruksioneve profetike për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës së trupit dhe ambientit. Kjo qasje do ta potenconte funksionin e fesë në pengimin e përhapjes së epidemive, infektive dhe sëmundjeve në përgjithësi.

“Prej funksioneve të fesë është edhe afirmimi i kujdesit ndaj higjienës me plotëkuptimin e fjalës higjienë. Së këtejmi, nuk është çudi që në Legjislacionin Islam (Fikh), kapitull i parë renditet pastërtia-babu et-tahareti, e cila është hyrja e parë për në adhurim. Të gjitha dispozitat që janë përmendur në këtë kontekst, si: larja e trupit (gusli) me qëllim fetar, abdesi për namaz dhe për adhurime tjera ku kërkohet abdes, duke i pas-truar gjymtyrët e dukshme të trupit, pastaj nxitja për pastrimin e duarve para dhe pas ushqimit, stimulimi i përdorimit të Misvakut (porosi nga ana e të Dërguarit të Allahut që të pastrohen dhëmbët dhe t’i jepet gojës erë e këndshme duke përdorur një degë të njomë peme), si dhe porosit në traditën pejgamberike që të pastrohen disa pjesë të cilat janë cilësuar si veti natyrore dhe mbrojtja e ushqimit nga kontaminimi dhe prishja, të gjitha këto janë instruksione shëndetësore që synojnë ta bëjnë higjienën kulturë të përgjithshme të cilën do ta jetësojë njeriu në jetën e tij”.⁷

▪ Përgjegjësia kolektive: Kjo është një pikë kyçe në tiparin edukativ të ligjërit fetar në kohë pandemie, që imamët me ligjëratat e tyre përmes mjeteve të komunikimit bashkëkohor nga distanca, arritën ta realizojnë dhe ta shndërrojnë në fokus të ligjërit dhe mesazhit të tyre. Me këtë rast, ata i kanë nxitur njerëzit që mos i neglizhojnë instruksionet e autoriteteve, por t’u përmbahen dhe t’i zbatojnë gjërat që u

⁷ Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, *Implikimet legjislative islame të zhvillimeve të reja nga paraqitja e pandemisë Covid-19*, përktheu prej arabishtes: Bashkim Aliu, Swiss Eci, 2020, Cyrih, f.18-19.

kërkohen. Në këtë mënyrë ata do ta mbrojnë veten dhe tjerët, dhe pikërisht kjo është vetëdija kolektive, kur njeriu mendon për të mirën kolektive, e jo vetëm për të mirën individuale. Në këtë aludon edhe thënia profetike: “Nuk ka dëm fillestar, dhe as dëm reciprok”.⁸ Dijetarët kanë shpjeguar se: “Ed-darer’ (dëmi fillestar) është ai që ty të sjell dobi, ndërkaq, fqinjët tënd i sjell dëm, ndërkaq ‘ed-dirar’(dëmi reciprok), është ai veprim që ty nuk të sjell dobi, ndërkaq e dëmton fqinjin tënd. Kuptimi i fjalës ‘ed-darer’ është veprimi me të cilin njeriu synon t’i sjell dobi vetvetes, e ta dëmtojë tjetrin, ndërkaq ‘ed-dirar’, është veprimi me të cilin njeriu synon ta dëmtojë tjetrin”.⁹ Detyrimisht, përgjegjësia kolektive konsiston edhe në tejkalimin e teorive konspirative përkitazi me këtë pandemi në veçanti dhe prapaskenat e mundshme nga kjo pandemi, ngase në të kundërtën, do t’ua ekspozonim njerëzit si rrezikut të infektimit me këtë virus, po ashtu, edhe sanksionimit nga ana e autoriteteve për mosrespektim të vendimeve të bazuara në ligje për parandalimin e përhapjes së epidemive dhe infeksioneve në shoqëri.

▪ Leximi i Kur’anit: Kur’ani ka vend të posaçëm te muslimanët, por nuk mohohet se paraqet objekt interesi edhe për pjesëtarët e besimeve tjera, apo edhe ata që thirren se janë ateistë apo agnostikë. Së këtejmi, jo vetëm tash, por edhe gjatë historisë, leximi i Kur’anit, në gjuhën arabe në të cilën edhe është shpallur, me zë para njerëzve, ka qenë praktikë e njohur. Kjo praktikë ka vazhduar edhe në këtë kohë, si në xhami, para namazit, po ashtu, edhe në kohën e pandemisë, përmes kanaleve të komunikimit *on line*, ashtu që xhamati i xhamisë përkatëse, si dhe tjerë që kanë dashur, kanë mundur të ndjekin lexim Kur’ani të drejtpërdrejtë të termine të lajmëruara paraprakisht nga imami, e që kanë qenë të njëjtat edhe atëherë kur janë frekuentuar xhamitë para pandemisë. Dëgjimi i Kur’anit ka ndikim te ata që e dëgjojnë, në veçanti ata të cilët e besojnë për libër të shenjtë, pra muslimanët, dhe vetë akti i dëgjimit të Kur’anit, është edukim, reflektim dhe përkushtim fetar.

MOTIVIMI: Ligjërimi fetar i imamëve në kohë pandemie ka qenë motivues për masën dhe jo demotivues, stimulues dhe jo dëshpërues, ngase në klimën e pasigurisë, panikut, qarkullimit të teorive konspirative në opinion, frikës për të ardhmen, duhej përdorur ligjërim i

⁸ Hadithin e ka transmetuar Ibn Maxheh në Sunen-in e tij, kitabu: el-ahkami, babu: men bena fi hakih ma jedurru bi xharihi. Ibn Maxheh, Ebu Abdullah, Muhamed ibn Jezid, *Sunenu Ibni Maxheh*, Bejtu-l-efkar ed-deulijje, Rijad, pa vit botimi, f.252, hadithi nr.2341.

⁹ Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, op. cit., f.20.

fuqishëm fetar motivues për masën, që të mund të tejkalohen të gjitha këto barriera. Me këtë rast, ligjëruesit fetarë, në ligjërimet e tyre, kanë vënë në pah disa pika kryesore të mësimave fetare islame në drejtim të motivimit të njeriut, në veçanti të njerëzve me halle dhe sëmundje, e që në këtu do të përqendrohemi në dy prej tyre:

- **Eliminimi i paqartësisë:** Pika kyçe në motivimin e njerëzve, në ligjërimin fetar në kohë pandemie, ka qenë eliminimi i elementit të paqartësisë, që si zakonisht është prezent në raste të këtilla dhe është një nga faktorët relevant të përhapjes së panikut, frikës dhe pesimizmit në shoqëri, duke u thirrur në praktikën profetike. Duke u folur njerëzve për atë se si i Dërguari i fundit i Zotit, Muhamedi, paqja e Zotit qoftë mbi të, i ka trajtuar epidemitë dhe sëmundjet infektive, si i ka këshilluar njerëzit të veprojnë në këto raste dhe çfarë shpërblimi ka ai që u përmbahet rregullave, duron dhe goditet nga epidemitë apo sëmundje tjera infektuese, ligjëruesit fetarë kanë krijuar vetëbesim të njerëzit, e kanë larguar hutinë dhe paqartësinë, ngase këto situata nuk qenkan të reja, por njerëzit edhe më herët qenkan ballafaquar me situata të këtilla, në veçanti vetë shoqëria e të Dërguarit të Zotit qenka ballafaquar me epidemi, dhe ai u ka folur për masat preventive. Ky lajm përbën faktor stabilizues për shoqërinë, e largon paqartësinë dhe frikën, si dhe përhap klimë optimizmi dhe shprese.

Në fakt, stimulimi, motivimi dhe optimizmi, sipas trashëgimisë profetike, janë elemente bazë të ligjërimin fetar në çdo situatë, e në veçanti në raste të këtilla delikate. Është transmetuar se këto kanë qenë këshillat profetike për misionarët dhe të deleguarit e tij me detyra fetare nëpër fiset e ndryshme. I ka porositur që të japin për njerëzit lajme përgëzuese e jo dëshpëruese, t'i afrojnë, e jo t'i largojnë njerëzit, t'ua lehtësojnë gjërat, e jo t'ua rëndojnë.¹⁰

- **Shpërblimi i të sëmurit durimtar:** Një element i rëndësishëm që e ka veçuar karakterin motivues të ligjërimin fetar në kohë pandemie, ka qenë fokusimi në shpërblimet që e presin të sëmurin durimtar i cili u përballon dhe u reziston sëmundjeve duke mos e humbur besimin dhe shpresën në Zotin, dhe duke mos i bezdisur njerëzit me ankime, psherëtimë dhe mallkime për sëmundjen. E tërë kjo ka qenë e mbështetur në

¹⁰ Në këtë drejtim flasin disa thënie profetike të cilat gjenden edhe në dy koleksionet autentike: Buhariu, kitabu: el-edeb, babu: kaulin-nebijji s.a.v.s., "jesirru ve la tua'ssiru". Shih: el-Askalani, op. cit., vëll. X, f. 541, hadithet nr.6124, 6125, 6126; Muslimi, kitabu: el-xhahadi ve es-sejri, babu: fi-l-emri bi tejsiri ve terki et-tenfiri. Shih: en-Nevevij, op. cit., vëll. XII, f. 36, hadithet nr.6,7,8.

trashëgiminë profetike, e cila është e qartë dhe e drejtpërdrejtë në këtë aspekt. Në një thënie qëndron se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Sa herë që një musliman sprovohet me vështirësi, sëmundje, pikëllim, bren-gosje ose depresion-madje qoftë ajo edhe shpim nga ferra, Allahu ia shlyen gjynahet për shkak të saj.”¹¹

PRAGMATIZMI TEOLOGJIK: Ligjërimi fetar nuk mund t’u ikë qasjeve teologjike dhe juridike legjislativë të fesë për fenomenet dhe ndodhitë. Megjithatë, është shumë me rëndësi se ç’drejtim do t’i jepet ligjërimin fetar në qasje ndaj fenomeneve, gjegjësisht do të dominojë ajo që do të mund ta quajmë edhe “dialektikë teologjike”, apo ajo që, sot në veçanti, preferohet të zen vend në sferën e shkencës juridike islame e që njihet si “fikhu-l-mekasid” disiplina e objektivave, që pa dyshim e ka vendin e vet edhe në analizën e fenomeneve teologjike të karakterit doktrinar, e jo vetëm juridik. Ligjërimi fetar në kohë pandemie i shmangi thellimit në debate për karakterin dhe prapavijën e epidemisë si ndëshkim, hakmarrje hyjnore dhe shprehje e zemërimit qiellor për gabimet e qenies njerëzore në tokë, por kryesisht u fokusua në trajtimin e dukurive të këtilla si shenja-ajete të Zotit, sfida për gjininë njerëzore, teste të përgatitjes sonë të gjithanshme si njerëz, por, të gjitha këto me qëllim të ngritjes së nivelit të kualitetit të jetës, kapaciteteve tona shkencore dhe mjekësore në përgjithësi, ngjalljes së solidaritetit mbarënjëror, strategjive ekonomike dhe financiare në nivel global, përmirësimit të kushteve të ambientit jetësor dhe politikës së qëndrueshme ushqimore.

Ligjërimi fetar, në kuadër të këtij tipari, u veçua me dy standarde të rëndësishme:

- Antifatalizmi: Ligjërimi fetar në kohë pandemie ishte nxitës i qartë i kërkimit të shërimit për sëmundje, mos dorëzimit para epidemive dhe marrjen e masave preventive për ta shmangur infektimin, që në fakt ka referencë më të fortë vetë praktikën profetike. Me këtë, u delegjitimuan qasjet fataliste të cilat thirrën në mosndërmarrjen e masave preventive, mosmbrojtje, mosnagazhim në kërkimin e ilaçeve dhe eliminin e sëmundjes, por dorëzimin në emër të asaj që preferojnë ta përdorin gabimisht “në dorë të Zotit” dhe “bëhet vetëm ajo që ka shkruar Allahu”, pa marrë parasysh si veprojmë ne, duke u thirrur në ajetin: ***“Thuaj: “Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga***

¹¹ Hadithin e ka transmetuar Buhariu në Sahih-un e tij, kitabu: el-merda, babu: ma xhae fi kefareti-l-merda. Shih: el-Askalani, po aty, f.107, hadithi nr.5641, 5642.

Allahu; Ai është ndihmëtar yni”. Prandaj, vetëm Allahut le t’i mbështeten besimtarët”.¹² Mirëpo, kësaj qasje fataliste, ligjërimi fetar në kohë pandemie iu kundërvu me qasjen tjetër, po ashtu, kur’anore që mos të hudhet vetja në rrezik. Ajeti: “... e mos hidhni veten në rrezik dhe bëni mirë, se me të vërtetë Allahu i do bamirësit”¹³, e mohon kuptimin dhe interpretimin ekskluzivisht fatalist të ajetit të mëparshëm, duke e precizuar qartë lidhjen shkak-pasojë, e që me fjalë tjera, e ven rezultatit brenda kontekstit të veprimeve që njeriu vetë vendos t’i bën. Kuptimi i përgjithshëm dhe konkret i tekstit të ajetit është deçiziv në domosdoshmërinë e shmangies me vetëdije të çdo situatë që ve në rrezik jetën e njeriut, apo e dëmton njeriun në ndonjë mënyrë. Teksti i ajetit është i qartë se njeriu nuk lejohet që me vetëdije t’ia ekspozon veten rrezikut. Këtu përfshihet edhe mbrojtja prej Pandemisë Covid-19, si një faktor serioz i dëmtimit të shëndetit të njeriut, edhe pse të gjitha grupmoshat nuk janë në nivel të njëjtë të rrezikut nga virusi që shkaktoi këtë pandemi.

- Besimi i fortë, goditet më fortë: Ligjërimi fetar në kohë pandemie u fokusua në risjelljen e thënieve profetike të cilat flasin për sprovat dhe vështirësitë me të cilat janë ballafaquar njerëzit më të dalluar të Zotit, të dërguarit e Tij, e pastaj edhe njerëzit e mirë, gjë që do të vazhdojë edhe më tutje, për t’u dëshmuar besimi i fortë, e jo për t’u ndëshkuar ata. Kjo mënyrë e komunikimit të përmbajtjes së thënieve profetike në opinion, paraqet stimulim për njeriun, largim nga gjendja e rënduar shpirtërore dhe psikologjike, mbrojtje për shëndetin mental të njeriut dhe mbrojtjen e shoqërisë nga pasojat negative të ngarkesave psikologjike të njerëzve. Transmetohet që Profeti i fundit i Zotit, Muhamedi, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, se ka thënë: “Më të sprovuarit ndër njerëzit janë të dërguarit e Zotit, pastaj më të mirët, dhe pastaj më të mirët (me radhë). Njeriu sprovohet në përputhje me (fuqinë) besimin e tij. Nëse feja e tij është solide, sprova e tij është e fortë; nëse feja e tij është e dobët, sprova e tij do të jetë më dobët. Me të vërtetë, njeriu mund të jetë shënjestër e shumë fatkeqësive derisa të ecë në mesin e njerëzve pa asnjë gjynah.”¹⁴ Ky përkufizim i sprovave me të cilat ballafaqohet njeriu, “ e pajis njeriun me energji të besimit e cila e udhëzon në të mirë si dhe e mbështet me fuqi morale që e aftëson

¹² Et-Teube: 51.

¹³ El-Bekare: 195.

¹⁴ Hadithin e transmeton Tirmidhiju në Sunen-in e tij, kitab: ebvabi-z-uhdi, babun fi es-sabri ala el-belai. Shih: el-Mubarekfurij, Muhamed Abdurrahman ibn Abdurrahim, *Tuhfetu-l-ehvedhij bi sherhi xhami’i et-Tirmidhij*, Daru-l-kutubi-l-ilmijje, Bejrut, pa vit botimi, vëll.VII, f.66-67.

t'i përballojë vështirësitë me guxim dhe me vetëpërmbajtje. Njeriu ka nevojë që të ketë imunitet të fuqishëm trupor dhe shpirtëror për t'u rezistuar sëmundjeve, gjë që e konfirmojnë edhe mjekët dhe ekspertët përkatës. Aq sa më i qetë shpirtërisht të jetë pacienti, aq është më i fuqishëm që t'iu përballojë sëmundjeve, normal, krahas ndërmarrjes së masave të domosdoshme të mbrojtjes dhe kurimit".¹⁵

Në fakt, sprovat janë ligj universal i Zotit në jetë, që do të thotë se të gjithë njerëzit, pa dallim feje, kombi, race, etj., ballafaqohen me sprovat. Kjo qartë shihet në Kur'an, ku thuhet: **"Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen, e Ne, në shenjë sprove ju sprovovjmë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne".**¹⁶

Kjo mënyrë e qasjes ndaj këtij fenomeni, jo vetëm që nuk e dëmton shëndetin mental të njeriut, por edhe e stimulon atë, e mbush me shpresë dhe me besim, e bën të fortë dhe i krijon mendim të mirë për veten se është i ngritur në besim. Së këtejmi, epidemia e parë nga ky këndvështrim, nuk është mallkim, por sprovë, ndërkaq sprovat e perceptuar në këtë mënyrë, nuk paraqet ndëshkim, por vërejtje për përmirësim dhe ngritje të njeriut.

KARAKTERI SOCIAL: Ligjërimi fetar i kohës së pandemisë e ka përfshi në masë të madhe elementin social, edhe atë duke u dhënë instruksione konkrete, së pari, udhëheqësive të xhamive që ta vazhdojnë komunikimin me anëtarët e xhamisë nga distanca, gjegjësisht duke i përdorur mjete bashkëkohore për komunikim që janë në disponim, e pastaj dhe masës së gjerë, që të kujdesen për njëri-tjetrin dhe mos i neglizhojnë obligimet ndaj shoqërisë. Instruksionet e këtilla bëheshin që përmes kësaj forme të komunikimit, të theksohet aspekti social i xhamisë, ngase komunikimi nga stafi drejtues i xhamisë me anëtarët, kishte për qëllim ofrimin e ndihmës për ata që kishin nevojë për ndonjë lloj ndihme, apo për t'u ndihmuar për nevojat të cilat vetë nuk mundnin t'i plotësojnë.¹⁷

Në këtë drejtim, imamët në ligjëratat e tyre gjatë kohës së pandemisë, vazhdimisht e kanë nënvizuar nxitjen e fesë për solidaritet dhe bashkëpunim në punë të mira, në veçanti në kohë krizash dhe për shtresat nevojtare. E gjithë kjo është ilustruar me ajete nga Kur'ani, thënie

¹⁵ Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, op. cit., f.12.

¹⁶ El-Enbija: 35.

¹⁷ Sa për ilustrim, shih instruksionet e Unionit të Bashkësive Islame Shqiptare në Zvicër, në: <https://daigs.ch/a-p-e-l-nga-daigs-per-kryesite-dhe-imamet-e-xhamive-ne-zvicer/>

profetike dhe raste konkrete nga jeta profetike dhe e shokëve të tij. Për të qenë të qartë, nënvizimi i këtij elementi, nuk është lidhur me përkatësinë fetare të palës që i ofrohet ndihmë, por me vetë nevojën e njerëzve, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre religjioze, etnike, racore, etj.

Ligjërimi fetar i cili ka përfshi aspektin social në këtë periudhë, nuk është ndalur vetëm në nivelin e ligjëratës, por ka kaluar në aktivitete konkrete. Kështu, shumë imamë dhe anëtarë të kryesive të xhamive kanë qenë të kyçur në aktivitete sociale dhe humanitare në komunat ku kanë gravituar duke bashkëpunuar me shtabet komunale të ngritura për këtë qëllim dhe duke kryer detyra konkrete të caktuara nga shtabet përkatëse. Ka pasur raste edhe kur janë organizuar fushata për grumbullim ndihmash për mbështetjen e institucioneve përkatëse në çdo vend për t'u përballur me pandeminë Covid-19.¹⁸

Kur jemi te tipari social i ligjërimit fetar në kohë pandemie, duhet theksuar edhe trajtimi i rëndësisë së raporteve familjare në Islam, ndëshkueshmërinë morale të ndërprerjes së lidhjeve fafesisnore dhe nevojën e komunikimit më të dendur me familjen. Kjo imponohet edhe si domosdoshmëri nga detyrimi i qëndrimit brenda në shtëpi dhe mos dalja jashtë, ashtu që duhet potencuar nevoja e organizimit të kohës me familje që të jetë sa më efektive në kuptime të ngritjes së tyre të gjithanshme, si dhe evitimit të problemeve dhe përplasjeve që mund të nxiteshin brenda familjes, si rezultat i kësaj gjendje.

CONCLUSION

The Covid-19 pandemic, which swept across the globe and affected almost all institutions and most of the economic activities, also led to the closure or suspension of collective religious ceremonies and rituals at places of worship of all religions.

Measures taken by the authorities to protect against the spread of the Covid-19 Pandemic, in every country, directly affect the mosques, as these measures consisted of the suspension of Friday prayers, congregational prayers and other activities that gathered a number of participants.

Imams with their online religious activity, continued to keep alive the soul of the believer by feeding him with religious messages, thus

¹⁸ Shih për këtë, sa për ilustrim, Aksioni i UBISHZ për të akorduar ndihma brenda Zvicrës në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Zvicrës, në: <https://daigs.ch/a-p-e-l-nga-daigs-per-kryesite-dhe-imamet-e-xhamive-ne-zvicer/>

putting their signatures in their key role in orienting the mass in the right direction and maintaining stability and cohesion in society in time of the Covid-19 pandemic.

Imams are focused on cultivating a sense of optimism and hope, combating pessimism and despair, encouraging people to show solidarity, cooperation, mutual aid, accountability and respect for the measures of public institutions. They have avoided doctrinal debates on issues raised during the Covid-19 pandemic, but have focused on social, psychological, humanitarian and religious issues, which have been necessary for the masses and the protection of human health.

Religious lecture in pandemic times has had several features, most important of which are: Educational Character, Motivation; Theological Pragmatism, which within this feature, is distinguished by two important standards: Anti-fatalism; The stronger the believer, the harder the hit; Social Character.

Recensentë:

Prof. dr. Nazmi Maliqi
Prof. dr. Afrim Osmani

LITERATURA

Aliu, Bashkim. *Roli i xhamisë në mbrojtjen e identitetit fetar dhe kombëtar në Perëndim*. Furkan ISM. Shkup. 2016.

Alu Shejh, Salih ibn Abdu-l-Aziz ibn Muhamed Ibn Ibrahim. *Sherhu-l-erbei'ne en-nevevijje*. Botimi i dytë. Daru-l-asime. Rijad. 2012.

el-Askalani, Ahmed, ibn Alij ibn Haxher. *Fet'hu-l-Bari*. Daru er-Rejan lit-turath. Kajro. 1986.

Ibn Maxheh, Ebu Abdullah ibn Jezid. *Sunenu Ibni Maxheh*. Bejtu-l-efkar ed-deulijje. Rijad. Pa vit botimi.

Jeken, Fet'hi. *Si të thërrasim në Islam*. Furkan ISM. Shkup. 2000.

Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime. *Implikimet legislative islame të zhvillimeve të reja nga paraqitja e pandemisë Covid-19*. Përktheu prej arabishtes: Bashkim Aliu. Swiss Eci. Cyrih. 2020.

Lashin, Musa Shahin. *Fet-hu-l-muni'm sherhu Sahihi Muslim*. Botimi i parë. Daru esh-Shuruk. Kajro. 2002.

el-Mubarekfuri, Muhamed Abdurrahman ibn Abdurrahim. *Tuh-fetu-l-ehvedhij bi sherhi xhami'i et-Tirmidhij*. Daru-l-kutubi-l-ilmijje. Bejrut. Pa vit botimi.

en-Nevevij, Jahja ibn Sheref. *el-Minhaxh bi sherhi Sahihi Muslim ibn el-Haxhxhaxh*. Daru-l-kutub el-i'lmijje. Bejrut. 1995.

Esh-Sha'ravi, Muhamed Muteveli. *Meusuatu-l-ehadith el-kud-sijje ve sherhuha*. el-Mektebetu et-teufikijje. Kajro. Pa vit botimi.

Xhibali, Muhamed. *Sëmundja, rregulla dhe dispozita*. Përktheu: Osman Osmani. Furkan ISM. Shkup. 2019.

<https://daigs.ch>